

PHI LAN THR OPY

edicioni 8

hapësirë e dedikuar

për FILANTROPINË

#philanthropy

— kontakt :   



©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI LAN THR OPY

hapësirë e dedikuar

për FILANTROPINË

Në këtë edicion



5

Rreth revistës

7

Të dhëna rreth
aktivitetit filantropik

janar - qeshor 2024

20

Rrathë Dhurues

27

Java e Filantropisë
2024

33

Smile.al

Publikohen tre
inicativa të reja

36

**Intervista me
përfaqësues të
nismave filantropike
në vend**

Klint Çollaku

44

**Fushata në ndihmë të
personave në nevojë**

48

Fondacionet Komunitare

50

**Studime të reja në
fushën e filantropisë**

Mirë se vini në edicionin e tetë të revistës Philanthropy!

Revista "Philanthropy" prej katër vitesh tashmë, vijon të jetë një burim i rëndësishëm informacioni mbi zhvillimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri.

Partnerët Shqipëri vijon punën e saj në drejtim të monitorimit mujor të **aktivitetit filantropik** në vend përmes medias dhe platformave online, duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të panoramës filantropike në Shqipëri. Në këtë seksion do të njiheni me fakte dhe të dhëna mbi aktivitetin filantropik në vend për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024.

Rrathë Dhurues - Shqipëri, rikthehet në vëmendjen e publikut përmes shpalljes së **Thirrjes Nr. 6 për Aplikime** për organizatat e shoqërisë civile të cilat synojnë të sjellin ndryshime të qëndrueshme në komunitete vulnerabël. Në këtë edicion ju prezantojmë gjithashtu me rezultate të punës së OSHC-ve të mbështetura nga eventit Rrathë Dhurues – 2023.

R
r
e
t
h
n
e
s
h



“**Java e Filantropisë 2024**”, këtë vit u organizua gjatë muajit prill, më një seri aktivitetesh për të rritur ndërgjegjësimin, promovuar aktivizimin dhe nxitur debatin publik, veçanërisht të të rinjve, mbi rëndësinë që ka ky aktivitet për zhvillimin e shoqërisë.

Smile.al e para dhe e vetmja platformë crowdfunding në Shqipëri ka shpallur **Thirrjen për Projekt Propozime**, e cila targeton organizatat jofitimprurëse në të gjithë vendin. Thirrja është e hapur deri më datë 30 gusht 2024. Gjatë kësaj periudhe tre iniciativa të reja komunitare u shpallën në platformë dhe në këtë edicion do të njiheni me to.

Në këtë edicion të revistës, kemi kënaqësinë t`ju prezantojmë me **Klint Collaku**, një i ri i cili përmes muzikës, dhe aktiviteve artistike ka ofruar mbështetje për fëmijët me aftësi ndryshe.

Fushata të ndërmarra në ndihmë të grupeve në nevojë vijojnë të jenë në fokus të këtij edicioni.

Partnerët Shqipëri në drejtim të promovimit të aktivitetit filantropik është përqendruar edhe në rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi **Fondacionet Komunitare**, dhe në vijim do të njiheni me disa nga përpjekjet më të fundit të PSh-së në këtë drejtim.

Nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e radhës, ju lutem shkruani tek erexhepi@partnersalbania.org

Lexim të këndshëm!

T Ë D H Ë N A R R E T H A K T I V I T E T I T F I L A N T R O P I K


J A N A R - Q E R S H O R 2 0 2 4

Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë **6 mujorit të parë të vitit 2024**, bazuar në monitorimin ditor të mediave, përfshi ato sociale, si dhe përmes raportimeve dhe publikimeve të institucioneve publike dhe jo - publike. Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që kanë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve. Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.


Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024, u regjistrua një numër prej **65,008 dhurimesh** me një vlerë dhurimi prej **281,546,539 Lekë** (2,801,450 Euro).

Krahasuar me të dhënat e gjashtë mujorit të parë të vitit 2023, **numri i dhurimeve është rritur me 20%** ndërsa **shuma totale e dhurimit është trefishuar përafërsisht**. Platformat crowdfunding online vijonë të jenë kanali kryesor i dhurimeve në vend.

Numri i dhurimeve sipas natyrës



Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë



Dhurimet sipas formës

Fjalorth

Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**, **Fushatave** dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

26 dhurime në formë të Drejtëpërdrejtë

102 dhurime përmes Eventeve

64,880 dhurime përmes Fushatave

Vlera e dhurimeve sipas formës



Dhurim i drejtëpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonale - Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Përfituesit e dhurimeve apo iniciativave që kanë një impakt në publikun e gjerë.

Miks - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

Tjetër - Cdo kategori tjetër që nuk i përket kategorive të mëparshme.

3 DHURUESIT KRYESOR

sipas numrit të dhurimeve

- #1 Banka Credins (18)
- #2 One Albania (17)
- #3 Food Bank Shqipëri (16)

3 DHURIMET KRYESOR

sipas vlerës së dhurimeve

#Dhurues Individë **20,683,603 Lekë**

Fushata për ngritjen e fondeve "Të shpëtojmë Nuredinin 12 vjecar me Leuçemi!", i cili ndodhet në gjendje shëndetësore të rënd.

#Dhurues Individë **16,725,213 Lekë**

Fushata për ngritjen e fondeve "Dhuro Fitrin dhe ushqe një familje në nevojë!", në mbështetje të familjeve në nevojë, gjatë muajit të Ramazanit.

#Dhurues Individë **12,985,374 Lekë**

Fushata për ngritjen e fondeve "Falu dhe bëj Kurban për hir të Zotit tënd!", në mbështetje të fëmijëve jetimë dhe familjeve në nevojë.

3 DHURUESIT MË TË MËDHENJ

sipas vlerës totale së dhurimeve

- #1 Banka Amerikane e Investimeve **7,176,713 Lekë**
- #2 Banka Credins **2,014,999 Lekë**
- #3 Kryqi i Kuq Shqiptar **1,700,000 Lekë**

Fushata për ngritjen e fondeve

203
Thirrje për Dhurime

36
Fushata përmes
platformave
Crowdfunding

7
Fushata përmes
Medias Sociale

81
Fushata përmes Medias Sociale
& Platformave Crowdfunding

16
Megafushata

2
Fushata përmes
platformës Facebook për
Impaktin Social*


Evente

102
Evente live

*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

Numri i dhuruesve sipas natyrës*


- Individë (69.33%)
- E panjohur (30.44%)
- Biznes i madh (0.09%)
- OJF (0.06%)
- NVM (0.06%)
- Institucion publik (0.01%)
- Institucion privat (0.01%)
- Institucion ndërkombëtar (0.01%)




*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

Vlera sipas natyrës së dhuruesit

- NVM
- OJF
- Biznes i madh
- E panjohur
- Individë
- Totali




Përfituesit Përfundimtar



- Publik i gjerë (37.3%)
- Fëmijë dhe të rinj (34.6%)
- Individë/Familje (27.2%)
- Tjetër (0.9%)



- Komunitet fetar (70.85%)
- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (28.53%)
- Publik i gjerë (0.47%)
- Zonë specifike (0.1%)
- Komunitete minoritare (0.06%)




- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (76.64%)
- Të moshuar (21.28%)
- Gra dhe Fëmijë në risk (2.08%)




- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (51.56%)
- Zonë Specifike (41.94%)
- Fëmijë dhe të rinj (0.29%)
- Të talentuar (6.13%)
- Komunitet minoritar (0.08%)

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

Gjatë 6 mujorit të parë të 2024-ës, **98.91%** e dhurimeve u shpërndanë në Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër jashtë vendit siç është paraqitur grafikisht më poshtë:



*Fier, Dibër, Pukë, Mat, Sarandë, Gjirokastër, Krujë.



Kosova



0.87%

E panjohur



0.15%



Shtete të tjera




0.07%

Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve

72.81% e dhurimeve janë kryer nga dhurues përmes platformave crowdfunding (e pidentifikuar vendndodhja), ndërsa pjesa tjetër nga dhurues nga Shqipëria dhe shtete të tjera.



* Fier, Durrës, Mat, Lezhë, Vlorë, Berat.



Crowdfunding



Shtete të tjera



Kosova




Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 **4** fushat kryesore të dhurimeve janë si më poshtë:


Ndërkohë kategoria "Tjetër" përfshinë dhurimet e kryera për: *Infrastrukturë publike (0.15%), Edukim(0.12%), Art dhe kulturë (0.08%), Zhvillimi ekonomik (0.07%), Të drejtat e njeriut / Angazhimi qytetar (0.04%), Ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit (0.04%), Sport (0.03%), Zhvillimi komunitetit (0.02%), Media e pavarur (0.01%), Dhurim sezonal (0.01%), etj.*

Qëllimi i dhurimit

- Shëndetësi
- Aktivitete humanitare me bazë fetare
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Zbutja e varfërisë
- Tjetër



Kanalet e dhurimit



A word cloud graphic featuring the number '461' in large black font, with the text 'lajme në media' below it in bold black font. The background is white with two red horizontal bars on either side. The word cloud consists of various media-related terms in red, including 'ARTIKUJ', 'EMISIONE', 'LAJME', 'REPORTAZHE', 'KRONIKA', and 'POSTIME', arranged in a circular pattern around the central number.

461 lajme në media

Gjatë vitit gjashtë mujorit të parë të vitit 2024, janë gjurmuar 461 artikuj në median e shkruar, audiovizive dhe atë sociale, të cilat mbulojnë fushatat dhe iniciativat dhuruese. Platforma më e zakonshme për këtë promovim ka qenë media sociale, Facebook, që është një nga kanalet e preferuara për shpërndarjen e informacionit rreth rasteve të dhurimit.

Njekohësisht, media vizive ka prodhuar një numër të konsiderueshëm emisionesh dhe reportazhesh të fokusuara në çështje të cilat kanë patur nevojë për mbështetje. Faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike kanë vazhduar të jenë një burim i rëndësishëm për promovimin dhe raportimin e zhvillimeve në fushën e dhurimit.

R R A T H Ë D H U R U E S

“Rrathë Dhurues” është një event i përvitshëm prej vitit 2018, i dhurimeve live, i cili u jep individëve mundësinë të bashkohen rreth një qëllimi filantropik për të mbështetur nisma komunitare që adresojnë nevoja të komuniteteve vulnerabël.

Në 6 dhjetor të vitit që lamë pas, shuma totale prej **2,306,505 Lekë**, e siguruar falë dhurimeve individuale, të bizneseve dhe OSHC-ve, kontribuoi në zbatimin e katër iniciativave, përkatësisht në Bulqizë, Fushë-Krujë, Shkozë dhe Korçë. Dy prej nismave duke qenë ndërhyrje infrastrukturore në komunitetet e targetuara, u inaguruan në muajin prill të këtij viti, ndërsa dy të tjerat finalizuan aktivitetet e tyre të mbështetura nga ky event.

Ju ftojme të njiheni me ndryshimet pozitive që ka sjellë në komunitete zbatimi i tyre:



#RrathëDhuruës
Shqipëri

Klasë burimore për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta

Më 18 prill 2024 u inaugurua "Klasa Burimore për Zhvillimin e Nxënësve me Nevoja të Veçanta" në shkollën e mesme "Rifat Manjani" në Shupenzë, Bulqizë.

Me një ambient të ri dhe të pajisur me mjetet e duhura didaktike, nxënësit me nevoja të veçanta kanë mundësinë të përparojnë në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale, duke synuar integrimin e tyre me bashkëmoshatarët. Përmes kësaj iniciative, pritet të rritet cilësia e edukimit dhe të mbështeten edhe mësuesit ndihmës dhe shërbimi psiko-social i shkollës në drejtim të ofrimit të një shërbimi cilësor.

Nisma u mbështet me një vlerë totale prej **622,645 Lekë** si dhe shërbime konsulence falas. Numri total i dhuruesve ishte **18** (5 individë; 6 OSHC dhe 7 biznese).



Rivitalizimi i “Sheshit Domino” në Fushë-Krujë

Që prej 22 prillit të këtij viti, banorët e qytetit të Fushë-Krujës gëzojnë një mjedis të ri dhe kreativ në shërbim të gjithë komunitetit. “Sheshi Domino” është simbol i përkushtimit të vazhdueshëm për të krijuar hapësira ku kreativiteti, inovacioni dhe angazhimi komunitar janë kryefjala.

Organizata “Porta Rome Për Integrim”, realizoi me sukses këtë nismë të mbështetur përmes dhurimeve të gjeneruara nga eventi Rrathë Dhurues 2023. Ky projekt transformoi “Sheshin Domino” në një zonë të sigurt dhe tërheqëse për të gjithë, duke përfshirë mbi 60 të rinj të cilët kontribuan në vënien në zbatim të kësaj nisme. Ambjentet e reja të “Sheshit Domino” në Fushë-Krujë u inaguruan në Ditën Ndërkombëtare të Tokës, përmes një eventi publik me pjesëmarrjen e bizneseve lokale, komunitetit lokal, OSHC-ve, institucioneve publike lokale, dhuruesve të ndryshëm që kontribuan përmes mbështetjes së tyre.

Nisma u mbështet me një vlerë totale prej **526,790 Lekë** si dhe shërbime konsulence falas. Numri total i dhuruesve ishte **12** (3 individë, 8 OSHC dhe 1 biznes).



Kutia e Periodës së Parë

Iniciativa "Kutia e Periodës së Parë," realizuar me sukses nga "Instituti për Zhvillim Strategjik", ka përfunduar të gjitha aktivitetet e saj me një ndikim pozitiv.

Duke ndihmuar vajzat adoleshente në zonën e Shkozës me shpërndarjen e "kutive të periodës së parë" dhe ofrimin e trajnimeve informative mbi shëndetin riprodhues, kjo ndërhyrje ka ndihmuar në eliminimin e stigmës rreth menstruacioneve dhe ka promovuar një kulturë të hapur dhe mbështetëse në komunitet.

Nisma u mbështet me një vlerë totale prej **324,570 Lekë** si dhe punë vullnetare të ofruar nga individë. Numri total i dhuruesve ishte **15** (11 individë, 3 OSHC dhe 2 biznese).



E ardhmja për fëmijët

Iniciativa "E ardhmja për fëmijët," realizuar nga organizata "Misioni Emanuel", ka përfunduar të gjitha aktivitetet e saj duke siguruar mbështetje për 100 fëmijë të grupmoshës 6-15 vjeç në qytetin e Korçës.

Kjo nismë ka ofruar programe edukative për fëmijët e targetuar si dhe për prindërit e tyre. Kontributi i vazhdueshëm në shërbimet për fëmijët dhe familjet e tyre, si dhe lehtësimi i mundësive për punësim për prindërit, ka sjellë një përmirësim të dukshëm dhe të qëndrueshëm në komunitet.

Nisma u mbështet me një vlerë totale prej **832,500 Lekë** si dhe shërbime vullnetare të ofruara nga individë. Numri total i dhuruesve ishte **16** (3 individë, 3 OSHC dhe 10 biznese).



**PHI
LAN
THRO
PY
WEEK**



**make
it the
way to...**

#bringChange



27

J A V A E F I L A N T R O P I S Ë

1 5 - 1 9 P R I L L 2 0 2 4

Gjatë datave 15 – 19 prill u organizua “**Java e Filantropisë 2024**”. Si pjesë e saj u organizuan një seri aktivitesh për të rritur ndërgjegjësimin, promovimin, aktivizimin dhe debatin publik, veçanërisht të të rinjve, mbi çështje të aktivitetit filantropik në vend.

J A V A E F I L A N



1 Leksione të hapura me studentë të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe Universitetit Europian të Tiranës

Dy leksione të hapura u organizua gjatë Javës së Filantropisë me studentë të vitit të parë të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe Universitetit Europian të Tiranës.

Tema e leksionit ishte: **“Impakti social dhe ekonomik i i aktivitetit filantropik në Shqipëri”**. Të rinjtë u njohën me disa nga nismat filantropike, si dhe platforma që mundësojnë dhurimet ndaj komuniteteve në nevojë. Pavarësisht se diskutimi mbi aktivitetin filantropik ishte një temë e re për studentët, përmes pyetjeve ata shfaqën shumë interes dhe shprehën mendimet e tyre lidhur me mënyrën e marrjes së informacioneve, rëndësinë që kanë dhurimet individuale dhe mbështetja nga biznesi, dhe vlerat që mbart ky aktivitet për zhvillimin e komuniteteve lokale.

TROPISË 2024

2 Intervistë me përfaqësues së Bankës Amerikane të Investimeve. Kontributi institucional në mbështetje të aktivitetit filantropik në vend

Gjatë Javës së Filantropisë 2024, patëm kënaqësinë të intervistojmë znj. Alda Shehu, Drejtore e Divizionit të Segmenteve Retail dhe Produkteve Retail/Non-Retail në ABI Bank.

Në këtë intervistë, znj. Shehu ndau përvojat dhe sfidat e ABI Bank në përmbushjen e misionit të tyre filantropik, si dhe projektet kryesore ku ata kanë investuar.

Nga monitorimi i aktivitetit filantropik për vitin 2023, Banka Amerikane e Investimeve (ABI) rezulton si një prej tre dhuruesve kryesorë në Shqipëri. Kjo arritje dëshmon përkushtimin e bankës në mbështetjen e komuniteteve në mbarë vendin. ABI ka lënë gjurmë në adresimin e nevojave të komuniteteve përmes iniciativave të ndryshme filantropike.

Për t'u njohur me intervistën e plotë klikoni [këtu](#).



3

Eventi - Krijimi i Partneritetit Efektiv mes Shoqërisë Civile dhe Biznesit

Në kuadër të aktiviteteve të Javës së Filantropisë 2024 u organizua event i **“Krijimi i Partneritetit Efektiv mes Shoqërisë Civile dhe Biznesit”**, duke bërë së bashku rreth 70 përfaqësues nga sektori i biznesit dhe organizatat jofitimprurëse nga i gjithë vendi.

Ky event, kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit mes këtyre dy sektorëve, në drejtim të nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve të targetuara. Si pjesë e eventit u zhvillua edhe një konkurs pikturë ku aktivistë, artistë të rinj nga Tirana, Durrësi, Fushë-Kruja dhe Bulqiza prezantuan përmes artit, konceptin e tyre mbi solidaritetin dhe filantropinë.

Konkursi i pikturës i dha ngjyra të reja aktivitetit, duke evidentuar kreativitetin dhe angazhimin e të rinjve në promovimin e vlerave të solidaritetit dhe filantropisë.



4

Trendet e dhurimit

Si pjesë e aktiviteteve të Javës së Filantropisë, PSh solli në vëmendjen e publikut përmes një serie publikimesh në mediat e saj sociale, fakte dhe të dhëna krahasuese mbi trendet e dhurimeve në vend për periudhën 2015 – 2023.

Bazuar në monitorimin ditor të medias së shkruar, vizive dhe sociale, si edhe publikime të institucioneve publike dhe jo-publike që prej vitit 2015 vërehet një rritje e trendit të dhurimit për nisma filantropike në vend.


Gjatë periudhës 2015-2023, vlera e dhurimeve, ka pësuar luhajtje të konsiderueshme. Në vitin 2015, dhurimet arritën në 587 milionë lekë, por më pas pësuan një rënie të ndjeshme në 2016 dhe 2017, përkatësisht në 186 dhe 64 milionë lekë. Ndërsa në 2018-ën vlera u rrit në 95 milionë lekë.

Prej fatkeqësisë natyrore të tërmetit, viti 2019 shënon vlerën më të madhe të dhurimeve, duke arritur një rekord prej 1,556 milionë Lekë. Kjo erdhi si rezultat i fushatave ndërgjegjësuese për mbështetje, rritjes së përdorimit të platformave crowdfunding (të cilat që prej fatkeqësisë natyrore të tërmetit kanë filluar të përdoren gjithnjë edhe më shumë) si dhe solidaritetit të rritur të të gjithë dhuruesve.

Ndërkohë, në vitin 2020, si rezultat i pandemisë COVID 19, dhe tkurrjes së aktivitetit ekonomik, vlera shënon një rënie në 104 milionë Lekë. Në vitet në vijim, dhurimet filluan të rriten gradualisht, duke arritur në 265 milionë Lekë në 2021 dhe 460 milionë Lekë në 2022.

Viti 2023 shënoi një tjetër rritje të madhe, me vlerën e dhurimeve që shkon në 1,278 milionë Lekë. Grupi i përfituesve mbetet i njëjtë ndër vite, ku fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të vecanta, dhe pa kujdes prindëror janë kategoritë kryesore që përfitojnë nga dhurimet.

Vlera totale e dhurimeve ndër vite



smile.al





S M I L E . A L

W W W . S M I L E . A L

Platforma Smile.al ofron një mundësi tjetër për mbledhjen e fondeve online, në mbështetje të nismave komunitare në fushat e shëndetit, solidaritetit, trashëgimisë kulturore, mjedisit, sipërmarrjes sociale dhe inovative, edukimit e trajnimit, dhe aktivitetet sportive.

T H I R R J E E H A P U R P Ë R P R O J E K T P R O P O Z I M E

Në platformë është shpallur **Thirrja për Projekt Propozime** e cila do të mbështesë nisma komunitare të propozuara nga organizatat jofitimprurëse. Thirrja do të jetë e hapur deri më **30 Gusht 2024**.

Ndërkohë njihuni me tre iniciativat e reja të prezantuara në platformë, të cilat kanë nevojë për mbështetjen tonë:



smile.al

AFATI I PREZANTIMIT TË PROJEKTEVE:
3 QERSHOR - 30 GUSHT 2024.

PËR MË SHUMË INFORMACION
WWW.SMILE.AL

Mbështetur nga:

 **CREDINS BANK**

 Vodafone Albania Foundation

 PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDËRTIMIN DHE ZHVILLIMIN

 Grant Thornton

 abi
AMERICAN BANK
OF ALBANY

3 INICIATIVAT E REJA



Më jep një shans të tregoj talentin tim!

Kjo nismë synon të krijojë klasën e artit pamor në shkollën 9-vjeçare të fshatit Zvezdë në Bashkinë e Maliqit. Në një zonë rurale me akses të kufizuar në shërbime, të rinjtë e Zvezdës kërkojnë mbështetjen tuaj për sigurimin e materialeve si pëlhura, bojëra, penela dhe stenda, që ata të kenë mundësinë të shfaqin talentin e tyre dhe ta zhvillojnë më tej atë. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#).



Mbështesim maternitetet për t'u kujdesur për të porsalindurit dhe për të shpëtuar jetë.

Gjatë periudhës neonatale, 0-28 ditët e parë të jetës, fëmijët janë më të brishtë për mbijetesën. Edhe pse ka pasur progres në Shqipëri në vitet e fundit, ende 7 në 1,000 fëmijë të lindur çdo vit nuk mbijetojnë. UNICEF në partneritet me Fondacionin Credins do të sigurojë inkubatorë dhe pajisje të tjera për disa maternitete në Shqipëri për të ndihmuar personelin shëndetësor në shpëtimin e jetës së fëmijëve. Do të ofrohen 10 inkubatorë për fëmijët që kanë nevojë për kujdes mjekësor të veçantë dhe 1 pajisje Bubble CPAP për mbështetjen e frymëmarrjes së porsalindurve të sëmurë në maternitete. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#).



Të kujdesemi që vetmia mos të na lërë më shumë rrudha në shpirt sesa në fytyrë.

Të moshuarit shpesh kalojnë shumicën e kohës në shtëpi pa aktivitete për t'u angazhuar. Ky izolim shpesh sjell një përkeqësim të shëndetit fizik dhe mendor. Me qëllim të përmirësimit të jetës psiko-sociale të të moshuarve në qytetin e Korçës, synojmë të zhvillojmë dhe të zgjerojmë funksionimin e katër qendrave ditore. Këto qendra do të ofrojnë aktivitete dhe shërbime të diversifikuara për të moshuarit. Ata do të kenë mundësi të takohen, të socializohen dhe të argëtohen në ambiente të përshtatshme që do të ofrojnë qendrat. Ekskursione dhe festimet e ditëlindjeve për 200 të moshuar do të jenë pjesë e aktiviteteve të këtyre qendrave. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#).

I N T E R V I S T A
M E P Ë R F A Q Ë S U E S
T Ë N I S M A V E
F I L A N T R O P I K E N Ë
V E N D



M B Ë S H T E T J E
P Ë R F Ë M I J Ë T
M E A F T Ë S I
N D R Y S H E

Klint Çollaku



Artist

Klint Çollaku u bë i njohur për publikun e gjerë që në moshë të re, kur mahniti spektatorët e spektaklit “Gjeniu i vogël” me interpretimet e tij mbresëlënëse të këngëve si “Makina e memories”, “Belle” dhe “Sytë e tu”. Sukseset e tij në këtë spektakël ishin vetëm fillimi, pasi triumfoi në “The Voice of Albania” e katapultoi drejt skenave më të mëdha dhe projekteve muzikore profesionale. Përveç talentit të tij në muzikë, Klinti e përdor këtë dhunti edhe për të ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë, duke kontribuar pranë Qendrës Xhonatan.

Ju lutem mund të na tregoni ku konsiston nisma juaj dhe shtysa për të ndërmarrë një nismë të tillë?

Nisma ime konsiston në mbështetjen e kauzës së fëmijëve dhe të rinjve me Sindromën Down përmes aktiviteteve të ndryshme edukative, sociale dhe kulturore që synojnë përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri. Kjo nismë synon të krijojë një mjedis mbështetës dhe të dashur për këta fëmijë dhe të rinj, duke u ofruar mundësi të barabarta për zhvillim dhe pjesëmarrje në jetën sociale.

Arsyet që më shtynë të ndërmarr këtë nismë janë të shumta. Fillimisht, kam pasur gjithmonë një ndjesi të fortë empatie dhe mbështetjeje për kauzat që lidhen me të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve. Kur pata kontaktin tim të parë me të rinjtë e Qendrës Xhonatan, ndjeva një dashuri dhe përkushtim të jashtëzakonshëm nga ana e tyre. Ishte një moment përcaktues për mua kur kuptova sa shumë mund të bëj për të ndihmuar dhe sa shumë mund të përmirësoj jetët e tyre me një përkushtim dhe mbështetje të vazhdueshme.

Gjithashtu, besoj fortë se secili individ ka një talent ose aftësi unike që mund të përdoret për të bërë një ndryshim pozitiv në botë. Ndjaj, vendosa ta përdor këtë aftësi për të krijuar dhe zhvilluar nismën "Dritë për Down" për të ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë me Sindromën Down të ndihen të përfshirë, të pranuar dhe të dashur në komunitetin tonë.

Në fund, një nga shtysat kryesore është dëshira për të thyer paragjykimet dhe stereotipet që ekzistojnë në shoqëri rreth fëmijëve dhe të rinjve me Sindromën Down. Dua që kjo nismë të jetë një shembull i asaj që mund të arrihet kur njerëzit bashkohen dhe punojnë së bashku për një qëllim të përbashkët dhe të mirë.



Muzikë Live
Me Klint Çollakun

12 Tetor 2023
Dyert hapen në: 18:00
Rruga Muhamet Deliu, Fresk



Aktivitetet ndër vite
#KlintonÇollaku



Pse ky target grup?

Target grupi që unë kam synuar kanë qenë të rinjtë me Sindromën Down. Zakonisht, shumica e aktiviteteve ku unë kam qenë pjesë duke dhënë mbështetjen time, kanë qenë në kryeqytet, në Tiranë.

Por, përveç aktiviteteve në Tiranë, kam marrë pjesë edhe në kampe verore jashtë Tiranës, ku të rinjtë me Sindromën Down kanë qenë pjesë e rëndësishme e këtyre aktiviteteve. Në këto kampe, kam pasur mundësinë të bashkëpunoj ngushtë me ta, të ofroj mbështetje dhe të ndihmoj në zhvillimin e aktiviteteve që i ndihmojnë të ndihen të integruar dhe të përfshirë.

Ndër eventet më të rëndësishme ku kam marrë pjesë, përmend Ditën Botërore të Sindromës Down të organizuar nga Qendra Xhonatan. Ky event ka një rëndësi të veçantë pasi synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë të drejtat dhe mirëqenien e personave me Sindromën Down. Gjithashtu, evente si “Night to Shine”, që janë të dedikuara për të rinjtë me nevoja speciale, jo vetëm me Sindromën Down, janë ndër organizimet ku nuk kam hezitur të jem prezent duke dhënë mbështetjen time.

Në këto evente, kam ofruar ndihmë në organizim, kam mbështetur pjesëmarrësit dhe kam qenë një zë për të promovuar barazinë dhe përfshirjen. Pjesëmarrja ime në këto aktivitete ka qenë një eksperiencë e vlefshme dhe më ka mundësuar të kontribuoj në krijimin e një mjedisi më të mirë për të rinjtë me Sindromën Down dhe nevoja të tjera speciale. Kjo më ka motivuar akoma më shumë për të vazhduar të mbështes dhe të punoj për kauzën e tyre.

Cili ka qenë impakti i arritur deri tani nga nisma?

Kësaj pyetje nuk do të doja të referohesha me shifra, pasi nuk janë specialiteti im dhe në raste të tilla nuk marrin vëmendjen time, edhe sikur pjesëmarrja të jetë e vogël në numër, kënaqësia ime do të jetë gjithmonë e madhe. Ndërkaq, për impaktin e lënë, kam shumë për të thënë.

Së pari, jam i sigurt se me organizime të tilla dhe nisma të tilla, mentaliteti rreth këtyre kauzave dhe mënyra e mendimit për ti mbështetur ndryshon, dhe numri i mbështetësve rritet dita-ditës.

Së dyti, familjet e personave me nevoja të posaçme shtyhen më shumë për të bërë fëmijët e tyre pjesë të organizimeve dhe institucioneve të specializuara për këto kauza, sepse ndiejnë vërtetë se fëmijët e tyre përkasin diku dhe nuk duhet të trajtohen aspak ndryshe.

Së treti, unë në çdo nismë, event ose organizim ku kam qenë vullnetarisht, kam parë lotë gëzimi, emocione dhe liri, dhe për mua kjo nuk ka çmim. Për mendimin tim, ky është qëllimi i vërtetë: të sjellim buzëqeshje dhe ndjesinë e shtëpisë tek të rinjtë me nevoja të posaçme.



Cili është plani juaj për të ardhmen?

Për mua, mbështetja e këtyre nismave është një çështje zemre dhe angazhimi im është i pandërprerë. Çdo herë që më jepet mundësia për të përdorur zërin tim dhe për të mbështetur nisma të tilla, unë jam aty pa hezitim.

Besoj fort se është detyra jonë si individë dhe pjesë e komunitetit të mbështesim këto kauza dhe të ndihmojmë ata që kanë nevojë. Shpresoj që edhe të tjerët si unë, të ndihen të frymëzuar dhe të angazhohen në të njëjtën mënyrë, duke sjellë ndryshim pozitiv në jetët e njerëzve.





F U S H A T A
N Ë N D I H M Ë T Ë
P E R S O N A V E N Ë
N E V O J Ë



Fushata

Disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve janar - qershor 2024.

#1

Rotary Club Tirana ofron një mundësi unike për të rinjtë shqiptarë dhe kosovarë, fitues të olimpiadave në Fizikë dhe Matematikë, për të ndjekur një shkollë intensive në Zvicër. Kjo nismë synon të përgatisë gjeneratën e ardhshme të shkencëtarëve dhe të rrisë konkurrencën globale të rajonit.



dhuro në smile.al

Ndihmo ekselencën shqiptare
në STEM

**MBËSHTETJE PËR SHKENCËN
DHE TEKNOLOGJINË NË
SHQIPËRI DHE KOSOVË**

#2

Në prag të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Mars, Credins Bank iu bashkua aktiviteteve social-artistike të FemFest, të cilat përfshijnë shfaqje artistike, teatrale, diskutime me shoqërinë civile, donacione, etj. Integrimi i gruas shqiptare, fuqizimi i saj ekonomik janë disa nga mesazhet kryesore senzibilizuese që përcollëm këto aktivitete.

MUZA JE TI



#3

Qendra Streha promovon diversitetin dhe përfshirjen në Shqipëri. Personalitete të skenës artistike, aktivistë LGBTI+, përfitues të shërbimeve të Streha-s, si dhe përfaqësues diplomatikë dhe politikanë shoqëruar me muzikë nga artistët Kamela Islamaj, Dimo Ada, dhe Alex Seitaj u bënë bashkë për të treguar se pavarësisht zgjedhjeve tona individuale të gjithë jemi të barbartë.

NJË NATË NGJYRE



NDAJMË BASHKË FESTOJMË BASHKË



#4


Big Market dhe Fundjavë Ndryshe u angazhuan për të ndihmuar familjet që jetojnë në varfëri. Ata i erdhën në ndihmë familjeve në nevojë duke ofruar ushqime dhe veshmbathje.

GREEN TIRANA




#5

Union Bank dhe Bashkia Tiranë mbollën 2000 bimë dekorative në Bulevardin Zogu i I. Union Bank është gjithnjë e angazhuar në projekte që shtojnë hapësirat e gjelbërta dhe përmirësojnë jetën e komunitetit.



F O N D A C I O N E T K O M U N I T A R E



Fondacionet Komunitare janë organizata jofitimprurëse që mobilizojnë burime lokale për të mbështetur iniciativa dhe projekte që adresojnë nevojat e komunitetit. Ato luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të atij komuniteti, duke promovuar filantropinë dhe pjesëmarrjen qytetare.

PËRPJEKJET PËR ZHVILLIM TË FONDACIONEVE KOMUNITARE NË SHQIPËRI

Eskperienat nga Evropa dhe më gjerë, kanë treguar se Fondacionet Komunitare kanë një impakt të madh, duke fuqizuar komunitetet, mbështetur zhvillimin social dhe ekonomik, dhe krijuar një kulturë të bashkëpunimit dhe solidaritetit. Përmes mbledhjes së fondeve dhe alokimit të tyre në projekte lokale, këto fondacione ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të qëndrueshme.

Duke vlerësuar kontributin e tyre, por edhe synuar të prezantohet një model të ri në vend, në vitet e fundit, fokusi i punës së Partnereve Shqipëri në fushën e promovimit të aktivitetit filantropik është përqendruar edhe në rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi fondacionet komunitare, si dhe në përpjekjet për zhvillimin e tyre në vend.

Përmes fushatave të ndryshme për informimin mbi funksionimin dhe rolin e fondacioneve komunitare, organizimin e takimeve me organizata jofitimprurëse, grupe informale dhe biznese si dhe hulumtimeve, Partnerët Shqipëri ka sjellë në vëmendje të publikut dhe institucioneve, rëndësinë e këtyre fondacioneve si motorë të ndryshimit social dhe ekonomik.

Këto aktivitete kanë ndihmuar në krijimin e një kuptimi më të thellë të rolit që mund të luajnë fondacionet komunitare në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Një tjetër aspekt kyç i punës sonë ka qenë mbështetja e 4 organizatave dhe grupeve informale përmes trajnimeve për *hartimin e planeve strategjike dhe mobilizimit të komunitetit, gjenerimin e të ardhurave si dhe krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit*, duke i prezantuar edhe në rrjete rajonale dhe Evropiane. Kjo mbështetje synoi iniciativat e para në nivel komunitar, fuqizimin e këtyre organizatave dhe për përmirësimin e aftësive të tyre për të adresuar sfidat lokale dhe për të zbatuar projekte me impakt.

Partnerët Shqipëri është e bindur se së shpejti edhe Shqipëria do të ketë një fondacion komunitar, i cili do të ofrojë një platformë që do të lejojë komunitetin të mobilizojë dhe administrojë burimet e tij në mënyrë transparente dhe efikase për të adresuar nevojat e tyre të përbashkëta dhe për të krijuar zgjidhje inovative për sfidat aktuale dhe të ardhshme.

Partnerët Shqipëri fton të gjitha organizatat jofitimprurëse dhe grupet informale të paraqesin interesin e tyre nëse dëshirojnë të asistohen në këtë drejtim.

S T U D I M E T Ë
R E J A N Ë
F U S H Ë N E
F I L A N T R O P I S Ë

Kuadri Ligjor dhe Rregullator i Aktivitetit Filantropik në Shqipëri

Partnerët Shqipëri ka publikuar së fundmi një studimin “**Kuadri Ligjor dhe Rregullator i Aktivitetit Filantropik në Shqipëri – Një Udhërrëfyes për Mbrojtjen e Aktiviteteve të Ngritjes së Fondeve të OJF-ve nga Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit**”.

Ky studim ofron një analizë të kuadrit ligjor dhe institucional mbi metodat e ngritjes së fondeve lidhur me aktivitetin filantropik, i cili kontribuon në veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri.

Përmes analizës së detajuar, raporti synon të ofrojë një kuptim se si ligjet dhe aktet nënligjore lidhur me aktivitetin filantropik ndikojnë në ngritjen dhe menaxhimin e fondeve për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri. Veçanërisht, raporti fokusohet në metodat e ngritjes së fondeve nga aktiviteti filantropik në këtë sektor.





Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tirana, Albania